



BASHKIA  
TIRANË

V E N D I M

Nr. 5779 / 12, datë 23.04 2020

"Për miratimin e Planeve të Detyruara Vendore, për Kontratat e Shërbimit Nr. 7981/17 Prot., datë 06.03.2020, Loti IV "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) Për Shpalljen e Zonës së Re Për Zhvillim Në Njësinë Administrative 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë, Nr. 7981/20 Prot., datë 06.03.2020, Loti I "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) Për Shpalljen e Zonës së Re Për Zhvillim Në Njesitë Administrative 4 dhe 8, Zona "5 maji", Bashkia Tiranë, Nr. 9952/9 Prot., datë 11.03.2020, Loti III "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) Për Shpalljen e Zonës së Re Për Zhvillim Në Njësinë Administrative 6, Zona "kombinat", Bashkia Tiranë"

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b" dhe nenin 23, pika 14 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenin 13, pika "dh" të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); nenin 72 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" (i ndryshuar); Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendimin nr.1, datë 14.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit; urdhëresën nr.28116, datë 24.07.2017 të Kryetarit të Bashkisë "Për procedurat e hartimit dhe miratimit të planeve të detajuara vendore" (e ndryshuar); urdhrin nr.11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë së Tiranës" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendimin nr.11987/1, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë (i ndryshuar), VKM Nr. 887 datë 24.12.2019 "Për Përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore", Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr.5779/3 datë 19.03.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e miratimit të planeve të detyruara vendore (PDyV);

V E N D O S A:


1. Miratimin e Planeve të Detyruara Vendore, për Kontratat e Shërbimit Nr. 7981/17 Prot., datë 06.03.2020, Loti IV "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) Për Shpalljen e Zonës së Re Për Zhvillim Në Njësinë Administrative 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë, Nr. 7981/20 Prot., datë 06.03.2020, Loti I "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) Për Shpalljen e Zonës së Re Për Zhvillim Në Njesitë Administrative 4 dhe 8, Zona "5 maji", Bashkia Tiranë, Nr. 9952/9 Prot., datë 11.03.2020, Loti III "Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) Për Shpalljen e Zonës së Re Për Zhvillim Në Njësinë Administrative 6, Zona "kombinat", Bashkia Tiranë"
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

Ditjon Baboçi  
Anisa Maçe  
Devis Agaraj  
Edian Meçe  
Iva Tavanxhiu

Drejtor i Përgjithshëm, DPPZHT  
Drejtor, DPT  
Përgjegjës, SM  
Specialist, SM  
Specialist, SM



KRYETAR

ERION VELIAJ

